

Prof. Dr. Ziber Lata\*  
Prof. Dr. Naser Ramadani\*\*

## FILLESAT E PËRKTHIMIT NGA GJUHA ARABE NË GJUHËN SHQIPE

Përkthimi i literaturës arabe në gjuhën shqipe ka filluar që në vitet e para, kur trevat shqiptare pranuan fenë islame, sepse ishin të detyruar, nga nevoja për të mësuar për fenë. Këta njerëz duhet të lexonin në gjuhën arabe, ose të përkthenin nga kjo gjuhë.

Nëse u referohemi fazave të ndryshme historike, do të shohim se pjesa dërrmuese e literaturës së përkthyer gjatë gjithë kohës ka qenë fetare, me përjashtime të vogla nga letërsia e bejtexhinjve.

### Përkthimi tek arabët

Para se t'i bëjmë një shtjellim të gjerë përkthimit nga gjuha arabe në gjuhën shqipe, mendoj se ia vlen të thuhet shkurtimisht disa fjalë për zanafillën e përkthimit të arabët.

Në qytetin e Halebit (qytet i Sirisë së sotme) është gjetur një dorëshkrim i vitit 513, i shkruar (apo i përkthyer) në tri gjuhë: në greqishten e vjetër, në gjuhën siriane dhe në gjuhën arabe. Mes të tjerave, në të numërohen emrat e burrave që e ndërtuan kishën, në të cilën u gjet vetë dorëshkrimi.<sup>1</sup> Ky është përkthimi i parë i dokumentuar tek arabët para islamit, kurse pas pranimit të fesë islame, arabët realizuan disa përkthime.

Përkthimi i mirëfilltë dhe në formë shkencore tek arabët filloi në periudhën e dinastisë emevite (viti 622 gregorian). Në këtë periudhë, filluan të përkthehen shumë libra shkencorë në gjuhën arabe. Halid bin Jezid bin Muavije (viti 704 gregorian) kur u largua nga pushteti, studioi diturinë dhe shkencën, më konkretisht kiminë, sepse ishte shumë i dhënë pas pasurive të çmuara nëntokësore. Pastaj, ai i urdhëroi shkencëtarët grekë

\* Pedagog në Fakultetin e Shkencave Islame, Shkup dhe Filologji Orientale, Tetovë

\*\* Fakulteti i Shkencave Islame, Shkup

1 Mona Baker dhe Sameh Fekry Hanna, "Arabic tradition", në : "Routledge Encyclopedia of Translation Studies", USA dhe Kanada: Routledge, 2009, f. 329

që gjendeshin në Aleksandri që të përkthenin nga greqishtja e lashtë në gjuhën arabe librat e kimit, si dhe të përkthenin “Organonin -koleksionin e librave të logjikës” të Aristotelit.<sup>2</sup> Kjo ishte iniciativa e parë zyrtare tek arabët myslimanë për të përkthyer një veprë të këtij niveli. Veprimtaria e përkthimit sa vinte e shtohet edhe më shumë, prandaj që atëherë përkthimi tek arabët mori hov të pandalshëm.

## Përkthimi te shqiptarët

Para se të gërmojmë në brendinë e përkthimeve nga gjuha arabe në gjuhën shqipe, ia vlen të thuhet disa fjalë për përkthimin në përgjithësi në gjuhën shqipe. Kur ka filluar përkthimi? Cilat janë veprat e para të përkthyer?

Përkthimi te shqiptarët është i pranishëm që në dokumentet e para të gjuhës shqipe. Vetë “Formula e pagëzimit” (1462), është një pagëzim universal i krishterë i përkthyer në shqip. Po ashtu, edhe “Fjalorthi” (1497) i udhëpërshkruesit austriak Arnold fon Harfi është një komponent shumë i rëndësishëm në lëmin e përkthimit. Pas tyre, kemi edhe shumë vepra të tjera leksikografike, të cilat janë në shërbim të përkthimit.

Këto ishin punimet e para të tërthorta në përkthimologjinë shqiptare, mirëpo

*“...të parët që u morën me përkthime (të drejtpërdrejta) ndër shqiptarët, qenë Buzuku me shqipërimin e veprës kishtarë “Meshari” (1555), Budi me përkthimin “Doktrina e krishterë” (1618), Bardhi me veprën leksikografike “Fjalor latinisht-shqip” dhe Bogdani, “Katër B-të”, siç i quan Vedat Kokona”.<sup>3</sup>*

Pavarësisht natyrës së veprave (frazave) të para të përkthyer, një gjë është e sigurtë, se ato kanë qenë kryekëput të sferës së religjionit. Po ashtu, do të shohim se edhe përkthimet e para nga gjuha arabe janë të natyrës fetare, dhe më pak janë vepra letrare.

## Si filloi përkthimi nga gjuha arabe në gjuhën shqipe?

Përkthimi nga gjuha arabe në gjuhën shqipe është një proces gjuhësor, por zanafilla e parë është jashtëgjuhësore, sepse ajo nuk ka filluar me

2 Ali Sami en-Neshshar, Menahixhul bahthi inde mufekkiril islam (metodologjia kërkimore te mendimtarët islamë), Kajro: 1965, f. 4

3 Edmond Tupja, “Këshilla një përkthyesi të ri” (botimi i dytë), Tiranë: Onufri, 2000, f. 10

motive gjuhësore, por si nevojë e myslimanëve të parë për të pasur qasje në Librin e Shenjtë dhe në tekstet e tjera fetare. Pra, në një mënyrë, përkthimi nga gjuha arabe rrënjët i ka në kohën e shtrirjes së fesë islame në këto treva, gjegjësisht në shekullin XV.

Pikërisht është kjo periudhë kur, përveç shfrytëzimit të përkthimit si mjet për ta kuptuar fenë, shqiptarët myslimanë nga gjuha arabe përvetësuan edhe grafinë (alfabetin), sepse ata jomyslimanë shfrytëzonin grafinë greke. Në këtë kohë nuk ekzistonte koncepti i nacionalizmit, prandaj transformimet fetare ndikonin edhe në transformimet e përkatësisë “kombëtare” dhe në ato kulturore. Orientalisti shqiptar Hasan Kaleshi, shprehet se shqiptarët që e pranuan fenë islame, në mungesë të një grafie (alfabeti të vetin), e përvetësuan edhe alfabetin arab. Pra, shtytja fetare bëri që ata ta mësojnë leximin e Kuranit në alfabet arab (grafinë), kur shumica e tyre nuk dinin shkrim e lexim tjetër, dhe pastaj filluan ta përdorin edhe për komunikimet e ndërsjella të zakonshme.<sup>4</sup> Kjo pastaj evoluoi edhe më shumë. Në fillim mësuam vetëm Kuranin, pastaj e përdornin alfabetin arab për nevoja të përditshme, kurse në fund filluan ta mësojnë edhe vetë gjuhën arabe, por ne na intereson vetëm përkthimi...

Pra, nëse bazohemi në këtë fakt, atëherë përkthimi i parë nga gjuha arabe në gjuhën shqipe me gjasë duhet të jetë vetë përkthimi i Kuranit, por sigurisht ky përkthim ka qenë i pjesshëm dhe jo i shkruar, thjesht kanë qenë disa ajete apo sure të shkurtra që janë transmetuar gojarisht nga njëri te tjetri. Nëse i kthehemi traditës islame shqiptare, do të shohim se ka qenë zakon mësimi i dhjetë sureve të fundit nga çdo mysliman në mekteb, ku hoxhallarët ua kanë mësuar myslimanëve edhe përkthimin e tyre, madje të njëjtat sure i kanë lexuar edhe në namazin e teravisë, në mënyrë që ato t'i mësojë mbarë populli.

## Etapat e përkthimit të literaturës arabe në gjuhën shqipe

Literatura arabe, siç theksuam më parë, ka depërtuar në gjuhën shqipe në formë graduale, prandaj për të pasur një pasqyrë më të qartë për zhvillimin e përkthimit të literaturës arabe në gjuhën shqipe do ta ndajmë atë në disa etapa të rëndësishme, kryesisht sipas ngjarjeve që janë zhvilluar në vetë botën shqiptare:

4 Shih: Hasan Kaleshi, “Kontributi i shqiptarëve në dituritë islame”, *Shkup: Logos-A, 2015*.

## a) Etapa nismëtare

Kjo etapë përfshin kohën kur arabët dhe turqit u dyndën nëpër trevat shqiptare për tregti dhe misionë. Pra, kontaktet e para mes shqiptarëve dhe arabëve ishin në periudhën e parë të depërtimit të islamit në këto troje. Ky kontakt filloi që në shekullin IX të erës sonë,<sup>5</sup> por me dyndje masive në shekullin XIV. Pra, në këtë periudhë çdo përkthim për nevoja fetare apo tregtare u bë në formë gojore.

Po ashtu, kjo periudhë përfshin edhe fillimin e instalimit të administratës osmane në trevat shqiptare. Administrata osmane, përveç gjuhës osmane si gjuhë zyrtare, në shumë segmente përdorte edhe gjuhën arabe, prandaj për ta kuptuar këtë pjesë shqiptarëve u duhej përkthyer edhe kjo gjuhë.

Sidoqoftë, përkthimi i shkruar nga kjo periudhë nuk ka mbetur.

## b) Etapa e bejtexhinjve – religjioni sfidonte nacionalizmin

Pasi shqiptarët e pranuan në masë fenë islame, filluan të shkollohen dhe të arsimohen nëpër qendrat islame nëpër botë, veçanërisht në Stamboll. Ata filluan të japin kontributin e tyre në sferat islame, kuptohet një pjesë e tyre shkruanin në gjuhën osmane, disa të tjerë në gjuhën arabe e perse, por kishte edhe prej atyre që shkruanin me grafi arabe, por në gjuhën shqipe. Krahas shkrimit, në këtë periudhë, filluan të përkthehen në gjuhën shqipe edhe vepra kapitale të fesë islame dhe të letërsisë orientale në përgjithësi, veçanërisht letërsia perse, arabe, por edhe ajo osmane. Fatkeqësisht, pak prej këtyre veprave kanë mbijetuar, ose ende janë të pastuduara nëpër arkiva.

Në epokën e letërsisë së vjetër shqiptare, gjegjësisht në letërsinë e bejtexhinjve, gjithashtu janë përkthyer nga gjuhët orientale shumë vepra, kryesisht poezi dhe poema me karakter fetar. Sa për ilustrim do t'i përmendim disa prej tyre: Muhamed Kuçuku ka përkthyer nga arabishtja një “Kaside Byrba”, ku kemi edhe vjersha kushtuar vdekjes së Muhamedit a.s., një Isasë dhe një njeriut. Prej Muhamed Kycykut kemi edhe një vepër tjetër të përkthyer nga turqishtja me titull “Terk-us-salavat” (Ai që lë faljen e namazit) me 416 vargje, kemi edhe një “Mevlud”, një “Binamazi” dhe një “Risale e Birgjevi”.<sup>6</sup> Nga mevludet, në periudhën e bejtexhinjve, më saktë në vitin 1879, është përkthyer në gjuhën shqipe (me grafi arabe)

5 Shih: Nexhat Ibrahim, “Historia dhe kultura islame shqiptare”, Vepra 10, Shkup: Logos-A, 2009 f. 283-293.

6 Mahmud Hysa, “Alamiada shqiptare II”, Shkup: Logos-A, 2000, f. 9.

mevludi i Sulejman Çelebiut nga shqiptari hafëz Ali Ulqinaku.<sup>7</sup>

Siç përmendëm më sipër, në këtë periudhë ka pasur të përkthyer edhe vepra letrare, edhe vepra fetare, në dallim prej kohës së sotme ku kanë vërshuar vetëm vepra të sferës fetare.

Një dukuri tjetër që meriton të theksohen në këtë rast është edhe poezia autoriale e autorëve shqiptarë. Frymëzimi i tyre ishte nga poemat, poezitë dhe gazelet në gjuhën arabe, perse dhe osmane. Në shumë raste ata bënëin përkthim të modifikuar, i cili pastaj dilte si punim autorial. P.sh. kemi “Qerbelañë” e Naim Frashërit, “Jusufi e Zelihaja” të Muhamed Çam Kyçyikut etj.

Sfidë e kësaj periudhe ishte mungesa e grafisë autoktone shqiptare, prandaj ata nuk ishin të motivuar për të bërë më shumë përkthime, por pasi bëhej fjalë për grafi të njëjtë (arabe), atëherë më me vend u dukej që ta mësonin vetë gjuhën arabe, sepse e njëjta do t’u shërbente për të kuptuar edhe tekstet fetare.

Po ashtu, duhet theksuar edhe një fakt tjetër, se ndjenjat e nacionalizmit shqiptar atëbotë nuk ishin zhvilluar edhe aq shumë, veçanërisht në periudhën e hershme deri në shekullin e XVIII, prandaj nuk ekzistonte motivi kombëtar që literatura të përkthehej. E rëndësishme ishte që njerëzit të kishin qasje në dituri dhe në shkencë, pavarësisht gjuhës, madje në atë kohë ishte privilegj të njihje gjuhët që udhëhiqnin botën.

Kjo periudhë filloi rënien e saj me daljen në skenë fuqishëm të nacionalizmit, gjegjësisht me shkrimet me karakter nacional të rilindësve. Mund të themi se kufiri i fundit i kësaj periudhe është pavarësia e shtetit shqiptar në vitin 1912.

### c) Etapa e pavarësisë – dyndje përkthimesh

Fundi i shekullit XIX dhe fillimi i shekullit XX, të gjithë myslimanët e Ballkanit, ndër ta edhe shqiptarët, i gjeti të zhytur nëpër luftëra të ndryshme, sepse Perandoria Osmane, pjesë e së cilës ishin edhe ata vetë, kishte marrë tatëpjetën, prandaj nuk ishte koha e shkencës dhe e përkthimit. Megjithatë, edhe në këtë periudhë kishte diçka të shkruar, por edhe të përkthyer.

Gjatë kësaj periudhe, u përkthyen nga gjuha arabe shumë vepra islame. Prej tyre kemi veprat e hafëz Ali Korçës,<sup>8</sup> i cili ka përkthyer pjesë

7 Hafiz Ali Ulqinaku, “Mevludi Sherif”, *Titograd, 1975, f. 3.*

8 Shih: Ismail Ahmed, “Vepra e Hafiz Ali Korçës”, *Shkup: Logos-A, I-X.*

nga Kurani në gjuhën shqipe, ka përkthyer “Rubairat” e Omer Hajamit etj.; Abdullah Zemblaku ka përkthyer dhjetëra vepra, po kështu edhe hafëz Ibrahim Dalliu etj.

Periodha më e vrullshme e përkthimit nga gjuha arabe është pikërisht periudha pas vitit 1923, vit kur u themelua edhe Komuniteti Mysliman Shqiptar (KMSH). Në këtë epokë, krerët e KMSH-së morën edhe iniciativa zyrtare për përkthime nga gjuha arabe. Në mesin e atyre iniciativave është pikërisht revista “Zani i Naltë” dhe revista “Kultura Islame”, në të cilat gjejmë përkthime të shkëlqyera nga gjuha arabe. Përkthimet e publikuara në këto dy revista të mbikëqyrura nga KMSH-ja kryesisht i takojnë sferës së mësimave islame, por ka edhe përkthime filozofike, letrare, gjuhësore, historike etj.

Këtë periudhë mund ta quajmë të përfunduar në vitin 1945, kur qeverisjen e Shqipërisë e mori Partia Komuniste Shqiptare, gjegjësisht sistemi famëkeq komunist me në krye Enver Hoxhën.

Që nga pavarësia në vitin 1912 dhe deri në vitin 1945, shqiptarët patën disa sfida në rrugëtimin e përkthimit nga gjuha arabe. Sfidë ishte vetë fakti se në fillim një pjesë e shqiptarëve nuk ishin të gatshëm ta pranonin alfabetin latin. Pra, sfidat kryesisht lidhen me faktorët politikë, sepse pas pavarësisë, shqiptarët asnjëherë nuk ishin të qetë, sepse u sulmuan nga serbët, italianët, gjermanët, dhe në fund iu zihet fryma përfundimisht nga komunizmi.

### ç) Etapa komuniste – përkthimi nga gjuha arabe ishte sinonim i krimit

Historia tregoi se planet antiislame në Ballkan, ndër vite nuk kishin të ndalur. Fillimisht, viset e banuara me myslimanë i copëtuan sa mundën, pastaj, për t’u dhënë goditjen e fundit, u instaluan një sistem politik të egër i cili çfarëdo që i dilte përpara e fshinte: shembën xhami, rrënuan mektebe, shkatërruan shkolla, dogjën libra, asgjësuan dorëshkrime, vranë e persekutuan dijetarë, përçmuan priftërinj e hoxhallarë etj. Atë mlllef që ata e kishin mbajtur për gjashtë shekuj ndaj Perandorisë Osmane, tani filluan ta derdhin mbi myslimanët e ngratë të Ballkanit gjatë shekullit të kaluar.

Kur jemi te kjo periudhë, fati i myslimanëve shqiptarë ndahet, zhvillimet intelektuale dhe historike për myslimanët shqiptarë nisën të frymojnë veçmas, varësisht sipas shtetit ku ata jetonin. Pra, tani kemi myslimanë shqiptarë të Shqipërisë, të cilët ishin të ngulfatur dhe nuk lejoheshin të merrnin as frymë, sepse në vitin 1967 përfundimisht edhe

me ligj ndalohet feja dhe fetaria,<sup>9</sup> dhe myslimanë shqiptarë jashtë shtetit politik shqiptar.

Këtë ndarje e bëmë për ta pasur më të qartë edhe veprimtarinë shkencore fetare të këtyre dy grupeve të shqiptarëve, sepse nuk ishte e njëjtë. Në Shqipëri nuk kishte asnjë mundësi për diçka të tillë, kurse në viset e Jugosllavisë ishte shumë e censuruar. Prandaj, tani mund të flasim diçka për përkthimet arabe në gjuhën shqipe në Jugosllavi, sepse në Shqipëri nuk kishte.

Gjatë kësaj periudhe, ishin pikërisht disa hoxhallarë të medresesë “Alauddin” në Prishtinë dhe të medresesë “Isa Beu” në Shkup, të cilët kontribuuan në përkthimin nga gjuha arabe. Po ashtu, këtu ndihmoi edhe Katedra e Orientalistikës pranë Universitetit të Prishtinës. Dy të parat kryesisht përkthenin literaturë fetare, kurse kjo e fundit sadopak mbulonte përkthimin e letërsisë, gjuhës dhe historisë nga gjuha arabe.

Në Shqipëri dënoheshe me vdekje vetëm nëse të gjenin duke kryer ndonjë rit fetar, kurse veprimtaria publicistike dhe botuese për botën arabe apo përkthime nga gjuha arabe as që mund të vihej në diskutim.

Sa u përket shqiptarëve të Jugosllavisë, ata ballafaqoheshin me shtetin dhe me botëkuptimin e vetë popullit, sepse marrja me gjuhën dhe letërsinë arabe, veçmas përkthimi nga kjo gjuhë, llogaritej si prapambetje dhe nënçmim, sepse këtë frymë kërkonte të mbillte vetë sistemi monist. Po ashtu, një sfidë tjetër e përkthimologjisë nga gjuha arabe në këtë periudhë, ishte edhe aspekti material, sepse atëherë nuk guxonte askush që të financonte apo të botonte një libër të përkthyer nga gjuha arabe, apo me frymë fetare.

Krahas të gjitha trysnive, historiografia shqiptare, pikërisht në këtë periudhë, u realizuan përkthimet më të rëndësishme të Kuranit në gjuhën shqipe.

#### d) Etapa postkomuniste – fokusimi në përkthime fetare

Vitet e nëntëdhjeta, si për Shqipërinë ashtu edhe për Jugosllavinë (apo Maqedoninë), bënë një kthesë politike, e cila pastaj ndihmoi edhe në veprimtarinë botuese.

Rënia e komunizmit në Shqipëri dhe e socializmit në Jugosllavi, bëri që të hapen mundësi më të mira për veprimtarinë përkthimore nga gjuha arabe. Këto dy dekadat e fundit u hapën shumë shtëpi botuese dhe u

9 Shih: Ali M. Basha, “Rrugëtimi i fesë islame në Shqipëri (1912-1967)”, Tiranë, 2011.

përkthyer shumë libra nga gjuha arabe.

Pa dashur të bëj numërimin e librave të përkthyer në gjuhën shqipe nga arabishtja, të cilët janë me mijëra,<sup>10</sup> do të ndalem në trajtimin e tipit dhe llojit të përkthimit.

Literatura e përkthyer nga gjuha arabe në këto dy dekadat e fundit, mbi 90 për qind është literaturë fetare islame. Pse vallë ishte e tillë?

Një arsye është se këta myslimanë vuajtën për gjysmë shekulli, prandaj tani për ta përbushur këtë nevojë, u dyndën në literaturën fetare, kryesisht nga gjuha arabe. Po ashtu, gjatë periudhës moniste, kishte shumë studentë të fesë në botën arabe, prandaj kthimi i tyre në vendlindje bëri që ata të fokusohen në përkthimin e asaj që kishin studiuar.

Problemi i fokusimit në literaturën fetare lidhet edhe me aspektin komercial. Shumica e shtëpive botuese dhe e librave të botuar kishin përkrahje nga bota arabe, gjegjësisht nga shoqata arabe, të cilat në emër të fesë kërkonin të shpërndanin vetëm fe dhe besim, dhe pothuajse aspak kulturë, letërsi dhe histori. Pra, thënë shkurt, ata financonin ideologjinë e tyre në viset tona. Në këtë formë, filloi të krijohet një polaritet mes shtëpive botuese dhe librave të përkthyer nga gjuha arabe. Problemet që i jetonte Lindja, erdhën edhe në mesin tonë. Këto veprime, shpesh të pavetëdijshme, bënë që shqiptarët ta humbin unin e vet fetar-islam, të cilin e kishin zhvilluar për plot pesë shekuj, por i cili ishte formësuar shumë bukur në gjysmën e parë të shekullit XIX.

Si përfundim nxjerrim se përkthimet fetare të përgjithshme nga gjuha arabe vazhdojnë të sundojnë tregun shqiptar. Kjo sigurisht është një gjë e mirë, por më mirë do të ishte që fokusimi i fetarëve të jetë te përkthimi i veprave profesionale dhe më të rëndësishme për islamin, dhe pastaj të përkthehet edhe letërsia, kultura, historia dhe filozofia e mendësisë arabe, sepse vetëm kështu do të jemi në gjendje ta kuptojmë drejt edhe thelbin e fesë islame.

### *Bibliografia*

1. Ali M. Basha, “Rrugëtimi i fesë islame në Shqipëri (1912-1967)”, Tiranë, 2011.
2. Ali Sami en-Neshshar, “Menahixhul bahthi inde mufekkiril islam

10 Shih: Maksim Gjinaj, Mehdi Gurra dhe Petrit Bezhani, “Libra në gjuhën shqipe për Islamin” (Bibliografi), vëllimi II, Stamboll: 2006; Rexhep I. Shahini, “Libri Islam në shqip – Bibliografi e 333 titujve”, Prishtinë: 2007.

- (metodologjia kërkimore te mendimtarët islamë)”, Kajro: 1965.
3. Edmond Tupja, “Këshilla një përkthyesi të ri” (botimi i dytë), Tiranë: Onufri, 2000.
  4. Hafiz Ali Ulqinaku, “Mevludi Sherif”, Titograd, 1975.
  5. Hasan Kaleshi, “Kontributi i shqiptarëve në dituritë islame”, Shkup: Logos-A, 2015.
  6. Ismail Ahmedi, “Vepra e Hafiz Ali Korçës”, Shkup: Logos-A, I-X.
  7. Mahmud Hysa, “Alamiada shqiptare II”, Shkup: Logos-A, 2000.
  8. Maksim Gjinaj, Mehdi Gurra dhe Petrit Bezhani, “*Libra në gjuhën shqipe për Islamin*” (*Bibliografi*), vëllimi II, Stamboll: 2006.
  9. Mona Baker dhe Sameh Fekry Hanna, “Arabic tradition”, në: “Routledge Encyclopedia of Translation Studies”, USA dhe Kanada: Routledge, 2009.
  10. Nexhat Ibrahim, “Historia dhe kultura islame shqiptare”, Vepra 10, Shkup: Logos-A, 2009.
  11. Rexhep I. Shahini, “Libri Islam në shqip – Bibliografi e 333 titujve”, Prishtinë: 2007.